VENDIM
Nr.594, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura organizative e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3 Numri i punonjësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të jetë, gjithsej, 6 veta.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, miratuar për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.

5. Vendimi nr.785, datë 22.11.2006 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të strukturës së nivelit të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT LIDHJA NR.1



LIDHJA NR.2

ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Pozicioni		Numri
Drejtor ekzekutiv		1
Inspektor (për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit)	1	
Inspektor (për standardet kombëtare të kontabilitetit)		2
Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit		1
Specialist (buxhet, financë, arkiv)		1
Punonjës gjithsej		6